


## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË (ASHSH)**

**DHE**

**ALBANIAN UNIVERSITY (AU)**



Tiranë, më 18.12.2020, Nr.500 prot.      Tiranë, më 18.12.2020, Nr. 651 prot.

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### NDËRMJET

AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË (ASHSH)

DHE

ALBANIAN UNIVERSITY (AU)

Neni 1

Përcaktimi i Palëve

Palët në këtë Marrëveshje janë:

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), me qendër në Tiranë, sheshi *Fan Noli*, e përfaqësuar nga akademik Skënder Gjinushi, Kryetar.
2. Albanian University (AU), me qendër në Tiranë, bulevardi *Zogu I*, i përfaqësuar nga prof. dr. Kaliopi Naska, Rektor.

Neni 2

Qëllimi

Marrëveshja ka për qëllim rregullimin e bashkëpunimit ndërinstitucional midis Palëve, si dhe midis strukturave përbërëse të tyre; përcaktimin e prioriteteve themelore të bashkëpunimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi e në parime të gjithëpranuara dhe në interesa të përbashkëta.

Neni 3

Parime bazë

Parim themelor rregullues për bashkëpunimin e Palëve është *autonomia*

*akademike dhe universitare.* Ato bashkëpunojnë duke respektuar njëratjetrën në vetëveprimin e tyre të rregulluar me ligje dhe me akte nënligjore, duke ruajtur dhe zhvilluar traditat më të suksesshme, përmes nismash, projektesh dhe veprimtarish të përbashkëta akademike e universitare.

Në veprimtaritë e përbashkëta dhe jashtë tyre Palët pranojnë dhe respektojnë Kodin europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor. Ato mbajnë qëndrim kritik dhe të papajtueshëm ndaj të gjitha formave të plagjiaturës dhe pseudoshkencës.

#### Neni 4

##### Drejtimet kryesore të bashkëpunimit

Bashkëpunimi midis Palëve shtrihet në gjithë fushat e dijes dhe shkencës.

Palët bashkëpunojnë me përparësi në shkencat albanologjike: *gjuhësi, arkeologji, histori, antropologji kulturore, trashëgimi shpirtërore e identitare, studime letrare e kulturore;* në disiplinat e reja të shkencave natyrore dhe teknike: *nanoshkencë* dhe *nanoteknologji; bioshkencë, bioteknologji* dhe *shkenca të jetës; inteligjencë artificiale;* si dhe në disiplinat që kanë lidhje me fusha imperative, si *tërmetet, pandemitë etj.*

Palët bashkëpunojnë për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, si: kuvende, kongrese, konferenca, forume, simpoziume etj.

Palët bashkëpunojnë për kryerjen e studimeve të përbashkëta.

Palët bashkëpunojnë për aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta shkencore vendore, rajonale dhe europiane.

Palët bashkëpunojnë për nxitjen dhe promovimin e studiuesve të rinj.

#### Neni 5

##### Bashkëpunime të veçanta

Njësitë bazë të studimit dhe Senati Akademik i AU marrin pjesë në procesin e promovimit të kandidatëve për anëtarë të Asamblesë së ASHSH, sipas parashikimit në Ligjin dhe në Statutin e saj.

Përfaqësues të trupës akademike të AU përfshihen sipas fushave në komisionet e përhershme që funksionojnë pranë ASHSH. AU mirëpret dhe inkurajon dhe pjesëmarrjen në këto komisione.

ASHSH garanton përfshirjen e ekspertëve të AU në *njësitë e reja* të

kërkimit shkencor ngritur pranë saj. AU rekomandon e propozon përfshirjen e ekspertëve më cilësorë, në këtë proces bashkëpunimi.

ASHSH fton përfaqësues të AU të marrin pjesë si anëtarë jurie, vlerësues të jashtëm, recensues dhe oponentë në organizimin dhe zhvillimin e konkurseve shkencore për çmimet kombëtare vjetore të shpallura prej saj, në të gjitha fazat e tyre.

Përfaqësues të AU marrin pjesë në organizma të ASHSH ose që funksionojnë pranë saj, si Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, Komiteti Kombëtar i AIESEE-së, komiteti vendor i ALE (Atlas Linguarum Europae), këshilli i botimeve akademike etj.

ASHSH fton në mbledhjet vjetore të Asamblesë së saj përfaqësues të AU. Anëtarë të Asamblesë së ASHSH, pjesë e profesoratit të AU, marrin pjesë me statusin e të ftuarit në mbledhje të Senatit Akademik të fushës së tyre kërkimore.

ASHSH dhe AU ofrohen për bashkëpunim për hartimin e programeve të veçanta të studimeve universitare për shkallët *master* dhe *doktoratë*, si dhe për drejtimin shkencor të tyre.

ASHSH mundëson zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve të AU pranë saj dhe njësive kërkimore të saj.

#### Neni 6 Shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit

*Palët i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbimin e ndërsjellë dhe të pakushtëzuar të informacionit shkencor, të periodikëve që batojnë, të studimeve dhe monografive. ASHSH u dhuron periodikisht koleksione të botimeve të saj bibliotekave të AU.*

*Palët shkëmbejnë ekspertiza dhe mbikëqyrje të përbashkëta të veprimtarisë shkencore në ekspedita dhe në kërkime.*

*Palët informojnë rregullisht njëra-tjetrën për marrëveshjet dy ose shumëpalëshe me interes të ndërsjellë.*

#### Neni 7 Zbatimi dhe kohëzgjatja

**Kjo Marrëveshje ka fuqi veprimi me kohë të papërcaktuar.**

**Palët takohen dy herë në vit për të vlerësuar ecurinë e Marrëveshjes.**

**Ndërprerja e saj pranohet prej Palëve në rastet kur:**

- Ndryshon statusi ligjor i institucioneve dhe ky ndryshim prek funksionet themelore të tyre, me efekt në Palën tjetër;
- Njëra nga Palët shpreh me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar shqetësimin për cenimin e interesave bazë të saj në procesin e plotësimit të kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

**Neni 8**  
**Protokollet e bashkëpunimit**

Me vullnetin e Palëve kësaj Marrëveshjeje i bashkëlidhen protokolle bashkëpunimi me afate realizimi që përcaktohen me diskutim mes tyre. Protokolle mund të nënshkruhen dhe për një veprimtari të vetme.

**Neni 9**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Kjo Marrëveshje është çështje dypalëshe. Për paqartësitë dhe ankesat e mundshme Palët nuk kërkojnë apelim në ndonjë instancë tjetër. Mosmarrëveshjet midis Palëve zgjidhen me bisedime.

Në rast të mosarritjes së dakordësisë për një periudhë dyvjeçare për çështje të diskutueshme, kjo Marrëveshje e humbet fuqinë.

**Neni 10**  
**Të fundme**

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në dy kopje, të dyja në gjuhën shqipe, një për secilën Palë, me vlerë të barabartë.

Për:

**Albanian University**

**Rektor**

**Prof. Dr. Kaliopi Naska**

**Akademinë e Shkencave të Shqipërisë**

**Kryetar**

**Akademik. Skënder Gjinushi**

